



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:153045

Datë: 13.01.2021

Numri i dokumentit: 01402957

**P.nr.274/2020**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit H. A. nga Gjilani, për shkak të veprave penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-ës, vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 i KPRK-ës dhe sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës, të cilin sipas autorizimit e mbron avokati Jeton Ibrahimimi nga Gjilani, të pandehurve D. I., A. B dhe H. A. për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, të pandehurve D. I dhe H. A për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, të pandehurve A. B dhe H. A. për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 lidhur paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-ës dhe të pandehurve D. I dhe A. B për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me nenin 35 dhe 31 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me numra PP.II.nr.1785/2020, të datës 02.11.2020, PP.II.nr.597/2020, të datës 26.05.2020, PP.II.nr.2013/2020, të datës 24.11.2020, PP.II.nr.1564/2020, të datës 30.10.2020, PP.II.nr.1302/2020, të datës 29.09.2020, PP.II.nr.806/2020, të datës 18.06.2020 dhe PP.II.nr.757/2020, të datës 10.06.2020, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar dhe pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurve, mori dhe publikisht me datë 18.12.2020 shpalli ndërsa me datë 13.01.2021 përpiloi këtë:

**AKTGJYKIM**

**Të pandehurit:**

- 1. H. A.** nga babai F. dhe nëna H., e lindur D., i lindur me datë ... në Gjilan ku edhe jeton, rruga: i martuar, baba i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme teknike, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës,
- 2. D. I,** nga babai A. dhe nëna M., e lindur K., i lindur më datë ..., në Gjilan ku edhe jeton në lagjen pa numër, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

3. **A. B.**, nga babai S.dhe nëna Xh, e lindur H., i lindur me datë ..., në Gjilan, ndërsa me vendbanim ne, Komuna e Novobërdës, ka të kryer 6 vite të shkollës fillore, i martuar, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

## **JANË FAJTOR**

### **I.**

#### **I pandehuri H. A**

Sepse me datë 02.04.2020, rreth orës 16:45 minuta në Gjilan, në përkatësisht në Qendrën Tregtare ... me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo për personin tjetër, ka kryer vjedhje në dëm të të dëmtuarës së lartcekur, në atë mënyrë që shkon në Qendrën Tregtare ...dhe aty merr tre përshuta, një të firmës ... dhe dy të firmës ... një shampon dhe një popkek, e pasi që kalon arkat ndalet nga sigurimi i marketit, me ç'rast të dëmtuarës së lartcekur i shkakton dëm në vlerë prej rreth 24.30 €

-Me çka ka kryer veprën penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 2 i KPRK-ës.

### **II.**

#### **I pandehuri Hasan Asllani**

Sepse me datë 06.07.2020, në intervalin kohor rreth orës 19:00-23:00, në Gjilan, në rrugën ... me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo për personin tjetër, ka kryer vjedhje në dëm të të dëmtuarës F. D, në atë mënyrë që ka kaluar murin dhe ka hyrë në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarës ku dera e oborrit ka qenë e hapur pastaj ka hyrë brenda në shtëpi, ku në shtëpi nuk ka pasur fare derë dhe ka marr një televizor të markës ... ngjyrë e zezë, në madhësi prej 32 inç si dhe disa gjëra ushqimore me të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm në vlerë prej rreth 180 €.

-Me çka ka kryer veprën penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-ës.

### **III.**

#### **I pandehuri H. A**

Sepse me datë 24.10.2020, rreth orës 15:30 minuta, në Gjilan, në rrugën ... i pandehuri pas një mosmarrëveshje me të dëmtuarin A. B. lidhur me një telefon, të njejtin e sulmon fizikisht duke

e goditur me grushte dhe duke ia dëmtuar syzet për shkak se i pandehuri deri sa kishte qëndruar në shtëpinë e të dëmtuarit ia kishte vjedhur telefonin, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta me dashje dhe pa pëlqimin e të dëmtuarit e ka sulmuar atë dhe ka përdorur forcën fizike ndaj tij.

-Me çka ka kryer veprën penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës.

#### IV.

##### **Të pandehurit H. A. dhe A. B**

Me datë 07.04.2020, rreth orës 15:12 minuta në Gjilan, në ,me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, ankuesit-tani të dëmtuarit Z. S nga Gjilani, ia marrin dy shishe me birrë alkoolike ,1litërshe në vlerë prej rreth 40 eurove, në atë mënyrë që merren vesh në mes vete dhe më pas shkojnë së bashku tek ky market, hyjnë brenda dhe nga vendi ku ishin të vendosura pijet alkoolike i marrin dy shishet e lartpërmendura dhe largohen nga aty, me ç'rast të dëmtuarin e kanë dëmtuar në vlerë prej 40 €.

-Me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-ës.

#### V.

##### **Të pandehurit H. A dhe D. I**

Sepse me datë 31.05.2020, rreth orës 15:57 minuta në Gjilan, në rrugën nga market ... pronë e të dëmtuarit Sh. T , nga Gjilani, me paramendim, me marrëveshje paraprake dhe me qëllim që ti sjellin vetit përfitim material të kundërligjshëm kanë marrë pronën në pronësi të të dëmtuarit ... duke hyrë në market dhe nga departamenti i mishit nga frigoriferi marrin përshutë në sasi rreth 2 kg, në vlerë prej 16.78 €, në atë mënyrë që i pandehuri H. A, mori dy copë përshutë nga frigoriferi dhe i vuri në nën xhaketë dhe pastaj ia dha një copë të pandehurit D. I i cili vendosi përshutën nën xhaketën e tij dhe më pas u larguan nga marketi dhe në këtë mënyrë të dëmtuarit i shkaktuan dëm material në vlerë prej rreth 16.78 €.

-Me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

#### VI.

##### **Të pandehurit H. A, D. I dhe A. B**

Sepse me datë 04.07.2020, rreth orës 19:05 minuta në Gjilan, në rrugën në marketin ... me marrëveshje paraprake dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete kanë dëmtuar marketin e lartcekur, në atë mënyrë që duke hyrë së bashku në market dhe duke marrë nga aty dhjetë çokollata millka dhe pesë deodorant të gjitha në vlerë prej 25 euro në atë mënyrë që A. B dhe H. A iu afron sektorit të ushqimit dhe morën nga pesë çokollata, në vlerë prej 10

euro ndërsa i akuzuari D. I, iu afrua sektorit të kozmetikës dhe mori 5 deodorant në vlerë prej 15 euro.

-Me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-ës.

## VII.

### **Të pandehurit D. I dhe A. B**

Sepse me datë 21.04.2020, rreth orës 17:24 minuta në Gjilan, në rrugën me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo personin tjetër kanë kryer vjedhje në dëm të të dëmtuarës ... në atë mënyrë që paraprakisht merren vesh mes vete dhe shkojnë tek marketi i lartcekur, me ç'rast i pandehuri Dorëllir merr 5 copë argeta, 2 konserva të peshqish pileta, 1 copë mish të terur, 2-3 çokolata millka dhe 1 lëng ndërsa i pandehuri Ardian merr 4-5 copë mish të terur dhe i fsheh nën jakne në pjesën e përparme më pas shkojnë tek kasa ku i pandehuri Dorëllir kishte paguar vetëm lëngun dhe dalin nga aty me ç'rast të dëmtuarës ... i shkaktojnë dëm në vlerë prej rreth 38.67 euro.

-Me çka kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 dhe 35 të KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4,38,39,40,42,43,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 dhe 365 të KPP-ës të pandehurit e lartcekur:

## I GJYKON

### **Të pandehurin H. H:**

Për veprën penale nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 ditëve,

Për veprën penale nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me gjobë në shumë prej 300 euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 ditëve,

Për veprën penale nga pika III e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 ditëve,

Për veprën penale nga pika IV e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 ditëve,

Për veprën penale nga pika V e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditëve dhe

Për veprën penale nga pika VI e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditëve,

**Të pandehurin D. I:**

Për veprën penale nga pika V e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditëve,

Për veprën penale nga pika VI e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditëve,

Për veprën penale nga pika VII e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditëve,

**Të pandehurin A. B:**

Për veprën penale nga pika VI e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditëve ndërsa

Për veprën penale nga pika VII e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditëve,

**Në bazë të nenit 80 paragrafi 1 të KPRK-ës, gjykata**

**Të pandehurin H.A** për veprat penale nga pikat I,II,III,IV,V dhe VI e gjykon me DËNIM UNIK me gjobë në shumë prej 300 € dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 2 (dy) muaj, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do të caktohet një ditë burgim.

**Të pandehurin D. I** për veprat penale nga pika V, VI dhe VII e gjykon me DËNIM UNIK me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë ndërsa

**Të pandehurin A. B** për veprat penale nga pikat VII dhe VII e gjykon me DËNIM UNIK me burgim në kohëzgjatje prej 160 (njëqindëgjashtëdhjetë) ditëve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Të dëmtuarit Qendra Tregtare ... në Gjilan, Qendra Tregtare ... në Gjilan, Qendra Tregtare ... në Gjilan, ... në Gjilan, ... në Gjilan”, A. B, Z. S. dhe F. D për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohen të pandehurit e lartcekur që secili prej tyre veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 50 euro dhe shumën prej 30 euro për kompensimin e viktimave të krimit, të

gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, në kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

## **ARSYETIM**

### **1.Rrjedha e çështjes**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë lidhur me çështjen penale kundër të pandehurit H. A nga Gjilani, për shkak të veprave penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-ës, vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 i KPRK-ës dhe sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës, të pandehurve D. I, A. B. dhe H. A. për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, të pandehurve D. I dhe H. A. për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, të pandehurve A. B dhe H. A për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 lidhur paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-ës dhe të pandehurve D. I dhe A. B për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me nenin 35 dhe 31 të KPRK-ës.

Me datë 18.12.2020, pranë kësaj gjykate është caktuar dhe mbajtur seanca fillestar, në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit, të pandehurit H. A, A. B dhe D. I si dhe mbrojtësi i të pandehurit H. A, avokati Jeton Ibrahimimi. Në këtë seancë gjykata duke vepruar sipas propozimi të mbrojtësit të të pandehurit H. A, avokatit Jeton Ibrahimimi për bashkimin e procedurave penale ndaj të mbrojturit të tij, pas dëgjimit të palëve dhe me pëlqimin e tyre mori aktvendim për bashkimin e procedurave penale me numra të lëndës si vijon: P.nr.314/2020, P.nr.341/2020, P.nr.772/2020, P.nr.849/2020, P.nr.878/2020, P.nr.956/2020 dhe P.nr.274/20 me ç'rast pas bashkimit të lëndëve seanca e shqyrtimit fillestar vazhdoi në rrjedhën normale ku pas leximit të aktakuzave lëndore secili prej të pandehurve të lartcekur veç e veç kishte deklaruar se i kanë kuptuar në tërësi aktakuzat dhe veprat penale për të cilat akuzohen si dhe atë se e pranojnë fajësinë për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohen me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurve.

### **2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë**

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezente palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se të pandehurit i kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e tyre, se të pandehurit nuk ka qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit ..., i datës 21.10.2020, deklarata e të dëmtuarës F. D, deklarata e

dëshmitarëve F. S., L.S dhe A. B, deklarata e të pandehurit H. A, raporti i hetuesit policor, dëftesa mbi konfiskimin e pronës dhe dorëzimi i televizorit të dëmtuarës, raporti fillestar i incidentit me numër të rastit ..., i datës 02.04.2020, deklarata e dëshmitarit Skender Abazi, deklarata e të pandehurit H. A, e dhënë para hetuesve policor me datë 02.04.2020, e kaluara kriminale e të pandehurit H. A, dëftesa mbi konfiskimin e pronës e datës 02.02.2020, formular i pronës i datës 02.04.2020, raporti i hetuesit policor, raporti fillestar i incidentit me numër të rastit ..., i datës 24.10.2020, informacionet e nxjerra nga data baza e policisë, deklarata e të dëmtuarit A. B dhe dëshmitarit A. B si dhe ajo e të pandehurit H. A të dhëna para oficerëve kompetent të Stacionit Policor në Gjilan, raporti i oficerit të Stacionit Policor në Gjilan, me numër të rastit ..., i datës 29.07.2020, raporti i zyrtarit policor në Gjilan, rasti nr.... i datës 29.07.2020, raporti i stacionit policor të Gjilanit, me numër të rastit ..., raporti fillestar i incidentit i policisë së Kosovës, rasti numër të rastit ... i datës 04.07.2020, raporti i zyrtarit të Stacionit Policor të Gjilanit, numri i çështjes ... i datës 04.07.2020, ..., raporti i oficerit të Stacionit Policor në Gjilan, me numër të rastit ... i datës 01.06.2020, dokumentacioni fotografik, raporti fillestar mbi incidentin e Policisë së Kosovës me numër të rastit ... i datës 31.05.2020, raporti i oficerit me numër të rastit ... i datës 31.05.2020 dhe CD me video incizim, raporti fillestar i incidentit me numër të rastit ..., i datës 22.04.2020, deklarata e dëshmitares S. D dhënë me datë 22.04.2020, deklarata e të pandehurve D. I dhe A. B, të dhëna në polici me datë 10.05.2020 dhe 17.05.2020, raporti i oficerit, foto dokumentacioni, e kaluara kriminale e të pandehurve, dëshmia lidhur me vlerën e sendeve të vjedhura dhe një CD me video incizim, formulari i dëshmisë me numër ..., CD-ja me incizimet nga vendi i ngjarjes, raportet e oficerëve të policisë dhe deklaratat e të pandehurve dhe të dëmtuarit të dhëna para oficerëve kompetent të Stacionit Policor në Gjilan, po ashtu gjykata në këtë çështje penalo juridike gjeti se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara nga neni 253 paragrafi 1 e 2 të KPP-ës dhe se aktakuzat nuk përmbajnë ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

### **3.Gjendja faktike e vërtetuar**

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

- I pandehuri H. A ka kryer veprat penale: vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-ës, vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 i KPRK-ës dhe sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikat I, II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.
- Të pandehurit A. B dhe H. A kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 lidhur paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

- Të pandehurit D. I dhe H. A kanë kryer veprat penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi.
- Të pandehurit D. I, A. B dhe H. A. kanë kryer veprat penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën VI të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe
- Të pandehurit D. I dhe A. B. kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me nenin 35 dhe 31 të KPRK-ë në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën VI të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

#### **4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurve tu shqiptohen dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, këto dënime do të jenë të drejta, në harmoni me peshën e veprave penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesve si dhe përgjegjësinë penale të tyre, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh *shkallën e përgjegjësisë penale të kryesve* e cila nga provat materiale në shkresat e lëndës del të jetë e lartë meqenëse të pandehurit H. A., D I dhe A. B. në kryerjen e secilës prej veprave penale për të cilat janë shpallur fajtor kanë qenë të përgjegjshëm për veprimet e tyre si dhe faktin se të njëjtit këto vepra penale i kanë kryer me dashje dhe atë dashje direkte për faktin se të njëjtit kanë qenë të vetëdijshëm se me veprimin e tyre do të kryejnë vepra penale dhe përkundër kësaj të njëjtit kanë ndërmarrë veprime siç përshkruhen në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe njëkohësisht edhe kanë dëshiruar kryerjen e tyre, gjykata pati parasysh edhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të mirës juridike ngase veprat penale për të cilat të pandehurit janë shpallur fajtor dhe janë dënuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bëjnë pjesë në kuadër të kapitullit XXVI, tek veprat penale kundër pasurisë dhe atë se të pandehurit me veprimet e tyre ia kanë marrë pasurinë personave të tjerë përkatësisht të dëmtuarëve me përjashtim të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës për të cilën i pandehuri H. A është shpallur fajtor dhe e cila vepër penale bënë pjesë në kuadër të kapitullit XVI, tek veprat penale kundër jetës dhe trupit dhe ky i pandehur me veprimet e veta tek i dëmtuari A. B ka përdorur forcën fizike duke e goditur të njëjtin me grushte, gjykata pati parasysh edhe pranimin e fajit nga ana e kryesit për kryerjen e veprave penale meqenëse të njëjtit në çdo fazë të procedurës penale secili prej tyre veç e veç kanë pranuar fajësinë për kryerjen e veprave penale të cilat iu vihet në barrë atyre, me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh edhe rrethanat personale të kryesve H. A dhe A. B meqenëse të pandehurit janë mbajtës të familjeve, janë të martuar dhe atë se i pandehuri H. A është baba edhe 1 fëmije.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të gjithë të pandehurit gjykata mori faktin se të njëjtit kanë pranuar



fajësinë për veprat penale të cilat iu vihen në barrë secilit prej tyre veç e veç në një fazë të hershme të procedurës penale, të njëjtit janë penduar dhe kanë shfaqur keqardhje për veprimet e tyre, kanë kërkuar falje për veprimet e tyre, faktin se të njëjtit kanë premtuar që në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale ndërsa si rrethanë rënduese për secilin prej të pandehurve gjykata mori shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personave në kryerjen e veprave penale ngase nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del se të pandehurit në kryerjen e secilës prej veprave penale kanë qenë të përfshirë si kryes apo bashkëkryes, duke i ndarë rolet në kryerjen e veprave penale dhe më pas duke ndërmarrë veprimet për kryerjen e tyre siç përshkruhen në dispozitiv të këtij aktgjykimi, po ashtu gjykata si rrethanë rënduese për të gjithë të pandehurit mori edhe shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të pandehurve sepse siç është theksuar më lartë nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del se të pandehurit këto vepra penale secili prej tyre veç e veç i kanë kryer me dashje dhe atë dashje direkte, gjithashtu si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori edhe faktin se këto vepra penale përfshinë shumë viktima përkatësisht 7 (shtatë) persona të dëmtuar.

Gjithashtu duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të pandehurve iu shqiptoj dënimet brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.6 të KPRK-ës, gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurve mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

## **5. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike**

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarit Qendra Tregtare ... në Gjilan, Qendra Tregtare ... në Gjilan, Qendra Tregtare ... në Gjilan, ... në Gjilan, ... në Gjilan”, A. B, Z. S dhe F. D i udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

## **6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale**

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurve, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurit secilin prej tyre veç e veç ti detyrojë ta paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe në emër të ligjit për kompensimin e viktimave shumën prej nga 30 € (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.274/2020, me datë 13.01.2021

**Zyrtarja Ligjore,**  
Eronita Llapashtica

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
Rilind Sermaxhaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.